

Shqyrtohet projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 16/2018 për Diasporën” në Komisionin për Politikën e Jashtme



Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 16/2018 për diasporën”, i cili vjen si propozim i një deputeti në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. I ftuar për këtë projektligj ishte ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 16/2018 për Diasporën” ka për qëllim përditësimin e tij me zhvillimet e fundit të strukturave shtetërore të ngritura për diasporën shqiptare. Më specifiku, në këtë projektligj është parashikuar të shtohet Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët si edhe të jepet përkufizimi ligjor i funksionit të Komitetit Shtetëror për Diasporën. Gjatë diskutimit, ministri Majko propozoi edhe disa shtesa për ta bërë Ligjin e Diasporës edhe më të plotë. Propozimet e tij ishin mbi nënin 5 dhe nënin 9 të këtij ligji. Lidhur me nënin 5, z. Majko propozoi që të autorizohet ministri përgjegjës për Diasporën për t'i propozuar Këshillit të Ministrave dhënien e bursave shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, e cila parashikohet në Vendimin Nr. 504, datë 24.6.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

Krijohet “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”, LinkedIn-i shqiptar



Projekti i Fondit Shqiptar të Diasporës për realizimin e “Rrjetit të Profesionistëve të Diasporës” ka filluar. Ai do të jetë një platformë ku të gjithë profesionistët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, ku do të takohen niveli profesional dhe shkëmbimi i informacionit. Ky është projekti më i ri dhe me ambicioz për të krijuar në fillesat e veta një “LinkedIn” shqiptar. “Rrjeti i profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë. Qëllimi i Platformës është të mbledhë dhe shkëmbejë informacione dhe përfshirjen e ekspertizës së anëtarëve të këtyre komuniteteve shqiptare në Diasporë dhe ti lidhë ato edhe me kërkesat e biznesit shqiptar apo të huaj në të mirë të zhvillimit të vendit. Ai synon në një fazë të dytë të shërbejë në gjenerimin e ideve dhe nismave nga komunitetet profesionale të Diasporës shqiptare. “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” mund ta gjeni këtu: www.rrjetiprofessionisteve.al.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsis shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Dhoma e Biznesit të Diasporës bashkon Dhomat e rajonit



Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, Fondi i Zhvillimit të Diasporës në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko kanë zhvilluar një aktivitet ku u prezantua puna e deritanishme e këtij organizimi dedikuar plotësisht sipërmarrjes shqiptare në Diasporë. Ministri i Shtetit për Diasporën në fjalën e tij tha se Diaspora shqiptare është burimi kryesor i stabilitetit ekonomik në Shqipëri dhe se së shpejti do të jetë pjesë e votës politike në vend. Ndërsa Kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës z. Ardian Lekaj bëri një prezantim të plotë të objektivave dhe qëllimeve Dhomës. Duke prezantuar filozofinë e punës së Dhomës së Biznesit të Diasporës, Lekaj e vuri theksin te potenciali i madh i Shqipërisë për investime si dhe bashkëpunimin për krijimin e një rrjeti të sipërmarrësve shqiptarë në Diasporë.

Aplikacioni Gazeta “Diaspora Shqiptare”

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Publikohet numri i dytë (Qershor 2020) i Buletinit për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës

Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën. Gjithashtu, Buletini informon anëtarët e strukturave vendimmarrëse lidhur me politikën, sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të reformës shtetërore për Diasporën.



“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Publikohet Periodiku i parë për vitin 2020: “Periodik 1/2020 Diaspora Shqiptare”



Ky botim vjen si produkt i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, i cili publikohet çdo gjashtë muaj. “Periodik 1/2020 Diaspora Shqiptare” përbëhet nga studime, raporte, artikuj dhe opinione, kryesisht falë kontributit të studiuesve e shkencëtarëve shqiptarë në Diasporë dhe Shqipëri. Tematika e përgjithshme e këtij Periodiku përmban raporte, analiza dhe studime, të cilat janë kryer nga institucione shqiptare dhe ndërkombëtare me veprimtari brenda dhe jashtë vendit dhe me në fokus migracionin shqiptar ndër vite. Gjithashtu, Periodiku është i fokusuar në vepra akademike dhe shkencore me të njëjtën temë.

Një “LinkedIn” për Diasporën Shqiptare



Drejtoresha Ekzekutive e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, znj. Blerina Turdiu, së bashku me Koordinatorin e Dhomës së Biznesit të Diasporës, znj. Linda Dervishaj, kanë prezantuar për televizionin A2 CNN dy platformat e fundit të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës: “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” dhe “Digjitalizimi i Veprave Shqiptare”.

Qendra e Botimeve për Diasporën publikon falas online fjalorin dygjuhësh për fëmijë, shqip-turqisht

Qendra e Botimeve për Diasporën vë në dispozicion të fëmijëve në Diasporë, një tjetër fjalor dygjuhësh për fëmijë: fjalorin shqip-turqisht, në formatin e-book. Fjalori, shumë i dobishëm për mësuesit dhe fëmijët në Diasporë dhe jo vetëm, është i shkarkueshëm falas për të gjithë. Fjalori dygjuhësh për fëmijë është konceptuar për fëmijë të moshës deri në 6 vjeç dhe shoqërohet me ilustrime të përzgjedhura me kujdes për t'i qartësuar dhe për t'i konkretizuar edhe më shumë fjalët duke i bërë ato edhe më të kuptueshme për fëmijët. Ky fjalor synon t'u japë fëmijëve të Diasporës një lëndë të pasur për të përmirësuar njohuritë e tyre në gjuhën shqipe, por gjithashtu mund të jetë shumë i vlefshëm edhe në procesin e mësimdhënies.

